

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Gjergj Erebara - Pse sajесat politike me skema ndihme për strehimin nuk e zgjidhin problemin?!
ADRESA	https://www.syri.net/politike/915984/pse-sajesat-politike-me-skema-ndihme-per-strehimin-nuk-e-zgjidhin-problemin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 15:15:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 14:24:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a7290ff7558ad6265cae29d5210846fadca2ef9b91c38bcc139862f417b0728d
TEKSTI	1b9f328b8c63b6242d331369bfccfed414eaa7a9063939d3c92ef2173d14a0d9
PAMJA	ef2a70c9c2e7bb95dae02483a7854f43bd2db1f9276195a9ef1cb38c1b14380a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4fb0b6e8382c29a8beb0999877ce539c80905fac6f78461229ac112a1cebb60e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	449e01d01289e86e32f44a76b2516514aa0ab1525100d1a30f454146706caeb7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4fb0b6e8382c29a8beb0999877ce539c80905fac6f78461229ac112a1cebb60e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Shoqëria shqiptare, duhet të fillojë betejën me heshtjen e SPAK-ut



IRENA BEQIRAJ
Në Shtetin e Ronit!



më të lexuarat

Sula: PISA 2025 u shënua me yll, OECD e futi Shqipërinë në 'raportim të kufizuar', qeveria fshehu të vërtetën

Ju përmend emri në bisedën e Ron Yeffet me biznesmenët ukrainas, gazetari Julian Hoxhaj reagon pas audiopërgjimit

SYRI TV/ Ermal Nufi i ikën si 'raketë' pyetjeve të Syri Tv për audiopërgjimin

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Noka në 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës: Liria nuk dhurohet, për të duhet luftuar

SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK



Pse sajemat politike me skema ndihme për strehimin nuk e zgjidhin problemin?!

16:24, 11/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Gjergj Erebara

Kryeministri Edi Rama është detyruar të flasë për politikë dhe politika, një ndryshim madhor ky nga historia e gjatë e tij që është e mbushur me shashka, batuta dhe nonsense. Propozimi i fundit, për skema subvencionimi për qiratë dhe kreditë, jo vetëm që nuk e zgjidhin problemin, por ka gjasa do ta përkeqësojnë atë.

Në Shqipëri, sipas censurit të fundit, 167 mijë familje, ose një në katër, jeton në banesa të vogla dhe të mbipopulluara, me hapësirë më të vogël se 18 metra

katrorë për trymë dhe ku komoditeti i një dhome me vete është luks. Përveç këtyre, në Shqipëri ka edhe 132 mijë familje që nuk kanë banesë të tyre, jetojnë me qira ose pa qira në banesën e dikujt tjetër.

Problemi i të gjithë këtyre familjeve është që të ardhurat e tyre janë të ulëta në raport me çmimet e qirave dhe të banesave për blerje. Dhe që përgjatë dekadës së fundit, çmimet e banesave janë rritur me shpejtësi më të madhe se sa të ardhurat, duke përjashtuar nga tregu i blerjes gjithnjë e më shumë familje.

E pra, në këtë situatë, njeriu që ka qeverisur vendin që prej tre mandatesh pa një program elektorale, u detyrua të flasë për një problem real. Ky njeri është Edi Rama. Ai deklaroi se ka në plan të ofrojë subvencionime për disa mijëra familje.

Analiza e problemit është gabim dhe zgjidhja e ofruar, jo vetëm që është gabim, por është edhe as më së largu e mjaftueshme për të zgjidhur problemin.

Sipas Ramës, problemi i strehimit do të zgjidhet me subvencionime të qirasë, me subvencionime të kredive, si dhe me transferimin e banesave të sekuestruara nga gjykatat si produkte të veprave penale të qytetarët në nevojë.

Sepse, në Shqipëri nuk është që të ardhurat janë të pamjaftueshme për të blerë shtëpi, është çmimi i shtëpive tepër i lartë përkundrejt të ardhurave. Çmimi i banesave është i lartë për disa shkaqe: e para, për shkak të korrupsionit. Lejet e ndërtimit jepen me korrupsion, kostoja e korrupsionit transferohet te çmimi i banesave. E dyta, rregullat urbanistike hartohen për interesa private, të cilat shkaktojnë kufizim në konkurrencë dhe çmime të larta. E treta, dhe ndoshta faktori më i madh, është që në tregun e apartamenteve dhe të ndërtimit është derdhur gjatë viteve të fundit një ortek me para droge. Ky ortek me para droge nuk i ka bërë shqiptarët më të pasur. Ai thjeshtë sa i ka inflacionuar jetesën shumicës dërrmuese.

Rrjedhimisht, zgjidhja e problemit të strehës së kushtueshme për ata që kanë nevojë për banesën e parë, si dhe për ata që kanë nevojë për zgjerim për kushte normale banimi, nuk konsiston në dhënie të disa mijëra subvencioneve për disa mijëra familje (nga 132 mijë që duan strehë, dhe 167 mijë të tjera që kanë nevojë për zgjerim), por te eliminimi i shkaqeve që kanë sjellë inflacionimin e çmimeve të banesave, pra eliminimi i korrupsionit në administratën shtetërore, hartimi i planeve rregulluese të ndershme dhe në shërbim të qytetarëve dhe, më e rëndësishmja, lufta pa kompromis ndaj parave të pista.

Sepse, siç thotë Adam Smith, vendi është i pasur ose i varfër, jo në raport me paratë që ka, por në raport me mallrat dhe shërbimet që prodhon. Nëse paraja në qarkullim rritet, fjala vjen, nga fitimet e drogës, ajo nuk kthehet në mirëqenie më të lartë. Ajo kthehet në inflacion.

SYRI TV/ Debate për audiopërgjimin e Ahmetajt, PD kërkon seanca dëgjimore për aferën

Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Bardhi: Rama hesht për audiopërgjimin ku miku i tij, Ron Yeffet, flet si i zgjedhur nga qeveria për të bërë punët e saj të këqija

Lexo edhe:



'Rama si një monark brenda një republike parlamentare',
Himçi: Kushtetuta, një leckë e hedhur në kosh



Dizdari: Ambasadori gjerman foli qartë, BE kërkon drejtësi dhe
luftë reale ndaj korrupsionit



Sekuestrimi i vilës së Ballukut, Bardhi: Kur do të veprojë SPAK
për kërkesën për heqjen e imunitetit...

TË NGJASHME



Berisha takon kongresmenin Joe
Wilson: Diskutim për narkotrafikun,
korrupsionin dhe gjendjen e
demokracisë në Shqipëri



SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë
pronë e KESH, ERE ka shtyrë
licencimin e tyre



'Po blejnë influencë të zyrtarët e BE',
Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë
lekë Universitetit të Tiranës për
Kolegjin e Evropës



Berisha në Konventën Republikane në
Dallas - Takime me drejtues të
Departamentit të Drejtësisë, Takime
me senatore



Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq,
përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?



Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20
kompani, kanë marrë monopolin në
disa fusha



25 vite nga 11 Shtatori, Berisha
kujton viktimat: Terrorizmi është
armik i njerëzve dhe popujve të lirë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.